



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.12.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtim i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Luan Duzha, Luan Harusha, Paulin Sterkaj, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Anduel Xhindi, Antoneta Dhima, Elona Gjebrea Hoxha dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Elona Hoxha, Myslym Murrizi, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunkshi dhe Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Teuta Vodo – Zëvendësministre i Drejtësisë

Juljan Hodaj –Zëvendësministër i Brendshëm

Eljona Bylykbashi – përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit.

Erion Sulejmani – Drejtori i Çështjeve Ligjore, Shoqërore dhe Shëndetësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Hapim mbledhjen e Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës kemi vijimin e shqyrtimit të projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Të ftuar kemi zëvendësministren e Drejtësisë, zonjën Vodo, zëvendësministrin e Brendshëm dhe drejtorin juridik të burgjeve. Faleminderit për prezencën!

Dua t’u kujtoj kolegëve se më herët ne kemi diskutuar në parim projektin dhe kemi mbajtur qëndrimet tona për këtë duke i kërkuar Ministrisë së Drejtësisë që ne të bënim kujdes në hartimin e këtij projektligji, me synimin e qartë që të vendosim një ekuilibër të drejtë midis qëllimit dhe nevojave që kemi për të parandaluar elementët kriminalë nga kryerja e mëtejshme e veprave penale në raport me të drejtat që ato kanë, të cilat ua njeh ligji.

Sidoqoftë, e shoh me vend që të mos humbim kohë, pasi bëhet fjalë vetëm për një nen. Të gjithë anëtarët e komisionit janë njohur edhe me opinionin e EURALIUS-it për shtimin e nenit të quajtur 41 bis në ligj, që lidhet me të drejtat e të dënuarve dhe të paraburgosurve. Kështu që dua të ftoj kolegët që të vijnë me diskutimin e pikës 1 të nenit 13/1, që mendohet t’i shtohet ligjit të sipërcituar.

Neni 13/1 titullohet “Regjimi i posaçëm i ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë”. Për pikën 1 të këtij ligji, sipas diskutimit që kemi bërë me ministrinë, ne propozojmë këtë riformulim: “Të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë dhe të paraburgosurit, që hetohen apo gjykohen për këto vepra penale, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 234, 234/a, 234/b, 283, paragrafi 3, 283/a, paragrafi 3, 284/a, 284/c, paragrafi 3, 284/ç, 287, 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste, mund të vendosen në një regjim të posaçëm të ushtrimit të të drejtave”. Po e shpjegoj pse kemi ruajtur këtë riformulim të pikës 1 të këtij neni. Sipas variantit që propozohet nga ministria, do të rezultonte se të gjithë të dënuarit që vendosen në burgun e sigurisë së lartë për këto vepra që citohen, automatikisht do të kalonin në regjimin e posaçëm, ndërkohë që regjimi i posaçëm është një situatë e jashtëzakonshme, nuk bëhet fjalë për një rrethanë të zakonshme dhe për këtë arsye ne e kemi ndarë që jo të gjithë të dënuarit, që dënohen për këto vepra, ose të gjithë të paraburgosurit që dyshohen të kenë kryer këto vepra penale, të vendosen në regjimin e posaçëm, përveç atyre, për të cilët ka të dhëna të qarta që e vijnë

aktivitetin kriminal edhe nga brenda ambientit ku ata mbahen si të arrestuar, të ndaluar apo duke vuajtur dënimin.

Kemi shtuar vetëm një nen në katalogun e veprave , i cili lidhet me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, që është neni 287. E kemi bërë këtë me arsyetimin se ky është një aktivitet, i cili kryhet i organizuar. Kështu që ne mendojmë që në momentin që ne vendosim regjimin e posaçëm për të dënuarit dhe të paraburgosurit, do të ishte mirë që në katalogun e veprave penale të shtonim edhe këtë vepër penale. Kush është dakord me këtë arsyetim për pikën e parë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjala “mund” është sepse nuk vendosen automatikisht dhe ato i sqaron pika 2 dhe pika 3, por, meqenëse ne do të kalojmë te miratimin në tërësi, nëse ka diçka për të korrigjuar, do ta bëjmë.

Xhemal Qefalia – Zonja kryetare, këtu parashikohet edhe për të burgosurit. Mos kemi të bëjmë me shkelje të të drejtave të njeriut, sepse për sa kohë që ai nuk ka një vendim të formës së prerë, pse do të paragjykohet vetëm me një akuzë?

Ermonela Felaj – Sepse ekziston rreziku që edhe i paraburgosuri, deri në kohën që ai të gjykohet dhe të marrë një dënim, të vazhdojë aktivitetin kriminal duke u lidhur me pjesëtarët e organizatës, grupit të strukturuar kriminal, bandës së armatosur, ku ai bënte pjesë, apo organizatës terroriste.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë besoj se ai do të kompensohet sipas të gjitha rregullave që janë në fuqi për dëmshpërblimin për burgim të padrejtë. Është e njëjta situatë që ne zbatojmë edhe për ata që janë dënuar, edhe për ata që janë të paraburgosur, megjithatë...

Xhemal Qefalia – Bëhet fjalë për masën shtrënguese, jo për kohën e qëndrimit në burg.

Ermonela Felaj – Qëllimi për të cilin ka ardhur ky projekt është i përbashkët për faktin, sepse rreziku i implikimit të mëtejshëm ekziston edhe për të dënuarit, edhe për të paraburgosurit. Ajo që po bëjmë ndryshe nga varianti që na propozohet është ky: në qoftë se ministria ka propozuar që çdo i dënuar ose i paraburgosur, që është në burgun e sigurisë së lartë, për njërën nga këto vepra futet automatikisht në regjimin e posaçëm, ne kemi thënë që jo të futet automatikisht, por vetëm kur është rasti. Pra, pavarësisht se ti je i dënuar për njërën nga këto vepra, nuk do të shkosh automatikisht në regjimin e posaçëm, por, nëse ka arsye që ti të shkosh në këtë regjim, patjetër që do të vendosesh në këtë regjim.

Debati për cenimin e të drejtave ose jo ishte një debat që ne e ezauruam edhe në mbledhjen e parë. Qartësisht regjimi i posaçëm cenon të drejta, por, kur kjo është e nevojshme, bëhet me ligj dhe në masën që është e nevojshme, natyrisht që është e lejuar.

Xhemal Qefalia – Nuk flas për ata individë, të cilët gjykata e ka çmuar dhe e ka vendosur që të kenë këtë akuzë. Nuk flas vetëm për prokurorinë, sepse prokuroria mund ta ketë akuzuar për një nga këto vepra, ndërkohë që e penalizon edhe këtu, mua më duket *non sens*.

Ermonela Felaj – Megjithatë, regjimi nuk është i përjetshëm, është i përkohshëm dhe, në varësi të rrethanave që shfaqen, regjimi hiqet. Ne thamë që ky është një ligj, që synon të adresojë më mirë luftën kundër krimit të organizuar. Kështu që të dy protagonistët e kryerjes së krimeve, qoftë ata që janë dënuar, qoftë ata që vijnë të hetohen, por ende nuk janë dënuar, duhet, kur është e nevojshme, të vihen nën këtë regjim. Hetimi i organizatave kriminale nuk është hetimi më i thjeshtë për prokurorinë dhe gjykatën, është një nga hetimet më të vështira që zgjasin edhe me vite. Tani çfarë do të thotë, që ne të jemi të vetëdijshëm që këta vijnë aktivitetin kriminal nga brenda burgut dhe vetëm për faktin që s'janë të dënuar, të mos marrin masa parandaluese?! Kjo do të na e rrëzonte të gjithë qëllimin që kemi, kështu që unë ju ftoj që ne ta miratonim këtë pikë, por me kujdesin, për të cilin ju jap shumë të drejtë, që jo çdokush që akuzohet apo dënohet për këto vepra, të vendoset automatikisht nën këtë regjim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në pikën 2 thuhet kur ndodh dhe kush e vlerëson. A jeni dakord me pikën 1? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Pika 2. “Vendosja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë bazohet vetëm në ruajtjen e rendit dhe sigurisë dhe/ose parandalimin e komunikimit me organizatën kriminale, ku bëjnë pjesë, apo me organizata të tjera të referuara në pikën 1 të këtij neni. Kohëzgjatja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë lidhet ngushtë me arritjen e qëllimeve të përmendura në këtë pikë”.

A ka ndonjë vërejtje për pikën 2? Kjo, në fakt, është e njëjtë në të dyja variantet që është sjellë, edhe në atë të ministrisë, edhe në atë të EURALIUS-it, ne thjesht kemi ndryshuar vendin, nga pika 3 e kemi bërë pikë 2, për të vënë qëllimin pastaj kush e zbaton. A jeni dakord me pikën 2?

Po, zoti Hodaj.

Juljan Hodaj- Ndoshta është kompetencë e Ministrisë së Drejtësisë kjo ku po ndërhyj unë, por, gjithsesi, invertimi i rendit ka një problem në vetvete, sepse pika 2 nuk është se përcakton ndonjë gjë. Domethënë, vendosja e një regjimi të posaçëm në tërësi, patjetër që i

shërbehet këtij qëllimi, por kam përshtypjen, besoj se do ta diskutojmë te pika tjetër, se do të ishte më mirë që kjo ekzigjencë të përmendej aty ku lejohet marrja e masave të brendshme dhe të jashtme për këtë qëllim, jo të dalë si qëllim më vetë.

Ermonela Felaj – Kjo pjesë që propozohet ka qenë para pikës 4, ku flitet për regjimin e posaçëm dhe çfarë nënkupton në detaj regjimi i posaçëm. Pra, ne kemi menduar që paraprakisht të tregojmë se cili është qëllimi që njerëzit vendosen nën regjim të posaçëm, ku qëllimi është që të parandalohet komunikimi me organizatën kriminale ku ata kanë bërë pjesë. Prandaj bënte sens që ta paraprënim pastaj të themi se kush e merr vendimin që këta të dënuar ose të paraburgosur të vendosen nën hetimin e posaçëm. A jeni dakord me këtë? kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Pika 3. “Vendimi për regjimin e posaçëm të ushtrimit të të drejtave merret nga ministri i Drejtësisë në bazë të propozimit të arsyetuar të drejtuesit të prokurorisë së posaçme, pas konsultimit me drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve”.

Dua të ndalem për një sqarim të vogël pse ne kemi mbështetur këtë variant dhe jo atë të Ministrisë së Drejtësisë. Ky është varianti që ka sugjeruar EURALIUS-i për ne, që vendimin ta marrë ministri i Drejtësisë, por ai nuk mund ta marrë këtë vendim i vetëm. Ne e kemi hequr ministrin e Brendshëm dhe e kemi zëvendësuar me drejtorin e policisë për faktin e mospolitizimit të situatës. Pra, përfshirja e dy ministrave më duket shumë e ngarkuar, ndërkohë që drejtori i Përgjithshëm i Policisë patjetër që është i njohur me situatën e kriminalitetit, me çështje të veçanta apo me prirjet e elementëve më të rrezikshëm kriminalë në vend dhe e kemi futur këtu drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, që ishte në të 2 variantet dhe drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, për arsyen e thjeshtë se me ndryshimet e reja që solli reforma në drejtësi, kompetencën për hetimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit e ka kjo prokurori dhe nuk do t'i hetojnë prokurori të tjera veprat e krimit të organizuar. Veprat që citohen këtu, janë vepra që kryhen në kuadër të organizatave kriminale ose grupit të strukturuar kriminal, pra janë pjesë e krimit të organizuar. Për këtë arsye, ne kemi mbështetur EURALIUS-in, i cili kërkon që përpara se ta marrë këtë vendim ministri i Drejtësisë të ulet me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, drejtorin e Burgjeve dhe, natyrisht, edhe me drejtuesin e SPAK-ut, që do të jetë së shpejti për të marrë këtë vendim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cilin rast?

Propozimin do ta bëjnë drejtuesit e policisë dhe ata të burgjeve.

Megjithatë, ka një ndërhyrje zoti Ndreu.

Pjerin Ndreu – Sipas Kodit të Procedurës Penale, urdhrin për ekzekutimin e një vendimi penal e nxjerr prokurori, i cili përlllogarit kohën e paraburgimit, llojin e burgut etj.

Në rastin konkret bëhet fjalë për persona që janë të dënuar, por ne dyshojmë nëpërmjet informacioneve, se ata kanë lidhje me rrjete të tjera ose me grupe kriminale të rëndësishme, që implikojnë drejtpërsëdrejti Prokurorinë e Posaçme në rastin konkret. Nuk bëhet fjalë për paraburgimin.

Unë mendoj se është e udhës të hiqet fare ministri dhe t'i delegohet drejtpërsëdrejti prokurorit të posaçëm, që ai ta kërkojë dhe ta vendosë. Të tjerët janë vetëm zbatues. Përderisa he q ministrin e Brendshëm, hiq edhe ministrin e Drejtësisë. Çfarë roli kanë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për veprat penale është kompetent prokurori i Prokurorisë së Posaçme. Ai, nëse vëren raste kur një i dënuar në hetim, ose ka të dhëna për një të dënuar, mbi bazën e tyre do të nisni një procedim, atëherë ndërhyt ai drejtpërdrejt.

Ermonela Felaj – A të bëj një ndërhyrje Pjerin?

Në vendosjen e llojit të burgut (burg i sigurisë së lartë apo i zakonshëm apo i sigurisë së ulët), prokurori bën kërkesë, ndërsa vendimin e merr gjykata, pra nuk e ka këtë kompetencë të ndërhyjë në llojin e burgut. Ai thjesht bën llogaritë për dënimin që duhet të vuajë dhe kohën që i mbetet, nëse e ka vuajtur një pjesë, për të saktësuar se kur do të dalë. Kështu, realisht unë do ta shihja me vend faktin që ndërhyt Ministria e Drejtësisë.

Edhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është një drejtori që varet nga ministri i Drejtësisë, ndërsa për ministrin e Brendshëm ne thamë arsyen pse e hoqëm, pra nuk është problem. Komisioni i Ligjeve që është komision përgjegjës, edhe mund të vendosë ta lërë, por ne gjykuam që përfshirja e dy ministrave duam apo s'duam, sidoqoftë i jep pak përmbajtje politike të gjithë gjësë, sepse ministrat janë organ politik. Kështu, thamë të vendosim një aktor më të drejtpërdrejtë, drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, për të ndihmuar punën. Kjo nuk bëhet për asnjë arsye tjetër.

Urdhëroni, zonja Vodo!

Teuta Vodo – Atëherë, ministri i Drejtësisë bën vetëm vlerësimin e ekzistencës së kushteve për zbatimin në vazhdim të këtij regjimi, pasi ka marrë një raportim nga 3 aktorët kryesorë (ministri i Brendshëm, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe prokurori që është duke kryer hetimet).

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Harusha!

Luan Harusha – Faleminderit!

Unë doja të dija se si e inicion çështjen Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve?

Ermonela Felaj - Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, prokuroria dhe Policia e Shtetit janë struktura që mund të vihen në dijeni të aktivitetit kriminal që vijon nga brenda burgut, prandaj bashkërendohen 3 aktorë për të çmuar që ky person është shumë i rrezikshëm dhe pikërisht për këtë dhe për faktin që mund të kryejë vepra të tjera penale edhe pse i është hequr liria, duhet ta fusim në regjim të posaçëm. Kjo është ideja. Pastaj, momenti se si do të ndodhë, kjo është çështje praktike, nuk është çështje që duhet ta përshkruajë ligji.

Luan Harusha – Unë doja të dija se kush e inicion çështjen dhe si. Ministria e Drejtësisë e inicion çështjen?

Ermonela Felaj – Ligji ua imponon si detyrim të gjithë drejtuesve të lartë që përmendëm, që në rastin kur ata shohin, marrin të dhëna nga hetimi, kur heton prokuroria. Nga të dhënat rezulton se grupi që po hetohet merr urdhra nga dikush që është brenda burgut. Në atë rast ai bën propozimin te ministri i Drejtësisë, që ky i dënuar të vendoset në regjim të posaçëm. Të njëjtën gjë bën drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë, sepse i kanë të dhënat për kriminalitetin dhe për elementet kriminale. Ky është mekanizmi.

Urdhëroni, zonja Vodo!

Teuta Vodo – Desha të shtoja se, gjithsesi është objekt kundërshtimi në gjykatë, kështu që nëse konsiderohet nga avokati mbrojtës, nga i dënuari, ose nga i paraburgosuri që është në kundërshti dhe nuk i plotëson kushtet, atëherë mund të jetë një rast që e gjykon vetë gjykata. Kjo është garancia.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Atëherë, kush është dakord me pikën 3?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se i kemi ezauruar pyetjet! Sot ose ofrohet ky variant, ose bie. Ju nuk jeni propozues të ligjit. Ne ju kemi thirrur, nëse keni ndonjë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Për cilën pjesë është ndërhyrja?

Julian Hodaj – Ndërhyrja është për pikën 3, sepse mënyra se si është parashikuar, e ndryshon totalisht atë pikë që ishte propozuar. Në versionin e parë që është propozuar për të cilin qeveria përfshirë Ministrinë e Brendshme, ka rënë dakord, parashikohet që këtë e rishikon gjykata dhe jo thjesht ministri i Drejtësisë.

E dyta, ministri i Drejtësisë nuk ka tagër ekskluziv për të marrë vendimin, por kushtëzohet nga një propozim i drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe e treta, nuk ka pse ministri i Drejtësisë të marrë mendimin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, apo atij të Burgjeve, sepse këtë të fundit e ka në varësi Ministria e Drejtësisë dhe i takon ministrit ta pyesë ose jo.

Për sa i takon komunikimit me institucionet e tjera, duhet që të jetë në komunikim edhe me ministrin e Brendshëm, sepse ai nuk ka në varësi vetëm Policinë e Shtetit, por edhe organe të tjera që kryejnë shërbime inteligjente dhe që mund të kontribuojnë në këtë çështje.

Ermonela Felaj – Po i rikthehem edhe njëherë diskutimit të ligjit. Ashtu siç është shkruar neni nga projektin e sjellë nga Ministria e Drejtësisë, nuk ka nevojë të marrë askush vendim, sepse në momentin që gjykata e ka vendosur në burgun e sigurisë së lartë, ai shkon automatikisht në regjim të posaçëm. Kështu ishte në projektligj, pra nuk bëhej fare fjalë për vendimmarrje dhe as për çmim të rrethanave që të çojnë në këtë vendimmarrje. Ne ndërhyrëm pikërisht, edhe mbi bazën e sugjerimeve që na kanë ardhur nga EURALIUS-i, që bën sens, sepse është një situatë që në rast se nuk përdoret siç duhet, mund të na çojë në shkeljen e të drejtave të njeriut dhe ne në këtë komision e kemi për detyrë ta kemi parasysh edhe këtë fakt, si përfaqësues të popullit. Pra, ne duhet të sigurohemi që të mos krijohen situata të tjera, që patjetër janë të papëlqyeshme për Shqipërinë, prandaj kemi mbështetur këtë variant. Siç e thashë, ne jemi komision për dhënie mendimi, jo komision përgjegjës. Komisioni i Ligjeve do të vendosë.

Atëherë, kush është dakord me pikën 3, të nenit 13/1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Kalojmë te pika 4, të cilën s'po e lexojmë të gjithën që është e njëjtë me variantin e propozuar nga Ministria e Drejtësisë dhe është mbështetur edhe nga EURALIUS-i. Pra, ku konsiston regjimi i posaçëm? Konsiston në lejimin e një takimi me familjarët në muaj; në lejimin e të dënuarit ose të paraburgosurit për të bërë vetëm një bisedë telefonike në muaj, që është 10 minuta dhe regjistrohet; në ndalimin e përdorimit të vlerave monetare, sendeve dhe objekteve që i dënuari dhe i paraburgosuri mund të marrë nga jashtë; në kontrollin e korrespondencës, përveç korrespondencës që bëhet me avokatët ose me organizatat ndërkombëtare, që veprojnë në fushën e mbrojtjes të lirive dhe të të drejtave të njeriut; në reduktimin e qëndrimit në ajrim jo më pak se 1 orë në ditë dhe natyrisht, çdokush që vendoset

në këtë regjim nuk mund të jetë pjesë e atyre organeve që vetë të dënuarit apo të paraburgosurit krijojnë për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Ka ndonjë koment për këtë pikë?

Urdhëroni, zoti Hodaj!

Julian Hodaj - Ka një gjë që nuk e shoh as te propozimi i EURASLIUS-it, as te propozimi juaj për pikën “a”, që është: “masa të brendshme dhe të jashtme të sigurisë së lartë, që lidhen, kryesisht, me nevojën për të parandaluar”. E reduktuar në këtë formë i bie që të jenë thjesht masa ndaluese të komunikimeve dhe të takimeve, në një kohë që për ta plotësuar qëllimin e vet, ky trajtim i veçantë ka nevojë për masa sigurie të jashtme dhe të brendshme, që do të thotë, duke filluar që nga organizimi i burgjeve të veçanta për këta të burgosur ose te seksionet e veçanta ose te degët e veçanta. Pra, ka nevojë edhe për një seri masash të brendshme të vetë institucionit.

Ermonela Felaj – E kuptova se ku qëndron ndërhyrja juaj. Ka kuptim, sepse germa “a” dhe më pas nënpikat që vijojnë, janë një përmbledhje të të gjitha masave që ne cituam më poshtë. Besoj se është një gabim që është bërë kur e kemi hedhur këtë pjesë të tekstit i riformuluar. Mendoj se nuk na krijon asnjë problem shtimi i tyre dhe bërja e kësaj pike, ashtu siç është propozuar.

Atëherë, kush është dakord me pikën 4 të këtij neni, në variantin e propozuar nga Ministria e Drejtësisë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Kalojmë te pika 5, ku thuhet: “Ministri i Drejtësisë, pas një periudhe një vjeçare, rivlerëson nëse janë kushtet për vazhdimin e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave ndaj të dënuarve ose të paraburgosurve të vendosur në një regjim të tillë. Për marrjen e vendimit, ministri i Drejtësisë merr paraprakisht mendimin e prokurorit, të Ministrit të Brendshëm, të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe të gjitha të dhënat e tjera të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, organet e Policisë së Shtetit dhe atyre të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, sipas fushave të përgjegjësisë. Ministri i Drejtësisë vendos zgjatjen e afatit për periudha të tjera njëvjeçare të ushtrimit të regjimit të posaçëm ndaj të dënuarit ose të paraburgosurit, kur ekzistojnë ende rrethana lidhur me:

a) aftësinë e të dënuarit për të mbajtur lidhje me organizatën kriminale apo terroriste, duke marrë në konsideratë edhe profilin kriminal dhe rolin e subjektit brenda organizatës, si dhe vazhdimin e veprimtarisë së bashkëpunimit kriminal;

b) ekzistencën e akuzave të reja, të pavlerësuara më parë;

c) rezultatin e trajtimit penitenciar, si dhe të standardit të jetesës së anëtarëve të familjes së subjektit.

Kalimi i kohës nuk përbën në vetvete, një element të mjaftueshëm për të përjashtuar aftësinë e të dënuarit në regjim të posaçëm për të mbajtur lidhjet me organizatën apo për të provuar mungesën e operativitetit të saj.”

Ku konsistojnë ndryshimet te ky riformulim? Kemi menduar ta vendosim këtu që ta detyrojmë ministrin e Drejtësisë që pas një viti të marrë në konsideratë vendimin e tij për vendosjen në regjim të posaçëm. Për analogji, kur dikush vendoset në një masë të shtrimit të detyruar në spital psikiatrik ose ndaj të cilit vendosen masa mjekësore Kodi i Procedurës Penale thotë saktësisht, se në krye të një viti gjykata e merr në konsideratë vendimin dhe vendos, nëse është rasti ta revokojë, ose jo.

Dikujt mund t’i bënte sens dhe të thotë me kërkesë të të paraburgosurit ose të të dënuarit. Personalisht, më duket e tepërt për faktin e thjeshtë, se kush do të ishte ai i dënuar apo i paraburgosur, që do të donte të rrinte në regjim të posaçëm? Askush.

Po ashtu, duhet të jemi koshientë që periudha e qëndrimit mund t’i degradojë njerëzit në aftësinë për t’u vetëmbrojtur, pra mund të bëhen të pambrojtur. Nëse ne e lëmë vetëm në dorë të tyre, i bie që po të kujtohet dikush, mund të dalë nga regjimi i posaçëm.

Unë them që ta bëjmë pjesë të përgjegjësisë së ministrit të Drejtësisë, sepse atij ia lamë edhe vendimin për të vendosur dikë në regjim të posaçëm. Në këtë mënyrë e zgjidhim situatën. Në të 2 variantet edhe në variantin që propozon vetë Ministria e Drejtësisë, edhe në variantin që propozon EURALIUS-i nuk është se gjejnë një kufizim të kohës në të cilën i dënuari mund të rrijë në regjim të posaçëm. Ti vetëm e sheh që mbas 1 viti, rivlerësohet masa në fjalë, nëse mund ta quajmë kështu.

Ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, aty nuk do të rrijë ministri, por do të rrijë drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, sepse ia thamë edhe ministres herën tjetër që ne mendojmë se duhet ta përshkallëzojmë bashkëpunimin në këtë nivel drejtuesish.

Urdhëroni, zoti Qefalia!

Xhemal Qefalia – Këtu ndoshta ka nevojë të përcaktohet se sa do të jetë afati që mund të shtohet, meqë kemi të bëjmë me rishikim të qëndrimit në regjimin e posaçëm. Kjo do të jetë me shumë interes, sepse kështu nëse ne do ta riciklojmë nga një vit e nga një vit, po rikthehemi te neni i mëparshëm. Fakti që masa rishikohet, ai ka të drejtë ta shtojë qoftë edhe me një afat të kufizuar dhe të mos lihet o 1 vit, o s’ka.

Ermonela Felaj – Ministria nuk është dakord në këtë pikë, sepse fakti që këtu është një fjali e tillë, që kalimi i kohës nuk përbën në vetvete një element të mjaftueshëm për të përjashtuar aftësinë e të dënuarit me regjim të posaçëm për të mbajtur lidhje me organizatën apo për të provuar mungesën e operativitetit të saj, tregon qartësisht se ke vetëm detyrimin për ta rikonsideruar çdo 1 vit. Kufiri më pas është i hapur se sa mund ta lësh.

Megjithatë, të dëgjojmë zonjën Vodo, nëse ministria ka ndryshuar mendim.

Teuta Vodo – Unë desha të komentoj diçka: drafti është strukturuar sipas modelit italian, i cili parashikon një periudhë 4-vjeçare, ndërkohë që ne e kemi reduktuar në një vit.

Gjithsesi, mendoj se është pikërisht i paraburgosuri, avokati i tij dhe i dënuari që mund ta vlerësojnë dhe mund të bëjnë kërkesën automatike pas një viti për të riparë regjimin. Mendoj se nuk përbën ndonjë problem...

Xhemal Qefalia – Dakord, por në nenin e fundit ju thoni, po e citoj: “Në qoftë se kërkesa kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë pranohet nga ana e gjykatës, ministri i Drejtësisë, në rast se do të urdhërojë një vendim të ri, duhet të mbajë parasysh përcaktimet e bëra në vendimin e gjykatës, duke shtuar elemente të reja ose duke e rivlerësuar nga ministri.”

Pra, ky mund të bëjë ankesë dhe ai mund ta shtojë përsëri. Kjo është nonsens, sepse nuk mund të shkojë pa fund kjo.

Ermonela Felaj – Më falni, a mund të ndërhyj një sekondë?

Bëtë shumë mirë që na e sollët në vëmendje nenin më pas, gjë që do të thotë se e vetmja mënyrë për të ndaluar vijimin e vendosjes në regjim të posaçëm për një kohë të pacaktuar, është pikërisht e drejta që do të kenë i paraburgosuri, i dënuari apo avokati i tyre për ta ankimuar në gjykatë. Gjykata do të vlerësojë situatën, nëse duhet të rrijë në regjimin e posaçëm, apo jo, sipas kuptimit që ligji i jep në vetvete regjimit të posaçëm.

Pra, periudha 4-vjeçare nuk ekziston këtu, zonja zëvendësministre. Këtu ekziston vetëm detyrimi që mbas 1 viti ta merrni në konsideratë vendimin që keni dhënë. Këtu thuhet shprehimisht: “Ministri i Drejtësisë vendos zgjatjen e afatit për periudha të tjera njëvjeçare të ushtrimit të regjimit të posaçëm ndaj të dënuarit ose të paraburgosurit...” Pra, çdo 1 vit mund ta zgjatësh me 1 vit tjetër.

Teuta Vodo – E mora si shembull për të thënë që ne e kemi përshtatur edhe në bazë të parashikimeve të bëra nga GJEDNJ-ja, e cila ka vlerësuar disa herë raste të tilla që janë çuar dhe prandaj është e vlerësuar tashmë nga kjo gjykatë. Gjithsesi, është e rëndësishme që të fokusohemi te fakti që kalimi i kohës nuk është në vetvete garanci, që është duke përjashtuar të dënuarin ose të paraburgosurin nga aftësia për të mbajtur lidhje kriminale me jashtë. Prandaj,

do t'ju ftoja të merrni parasysh faktin që 1 vit është një kohë relativisht e shkurtër dhe jo automatikisht duhet të jetë vetë gjykata që rivlerëson regjimin.

Ermonela Felaj – Atëherë kolegë, duke qenë se ne nuk e vendosim përfundimisht përmbajtjen e draftit dhe, meqenëse ka edhe një arsye tjetër, sepse pjesë e Komisionit të Ligjeve është edhe Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut dhe çështja e kohëzgjatjes së regjimit të posaçëm është një çështje tipike që do ta shqyrtojë ky nënkomision. Kështu, mendoj të mos ta vijojmë më tej diskutimin, sepse nuk ka kuptim, të paktën kjo nuk hyn në kompetencën e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. madje neve do të na interesonte e kundërta. Le t'ia referojmë këtë moment Komisionit të Ligjeve, duke i thënë që këtë kohë e kemi lënë të hapur. Nëse ata e shohin të arsyeshme që këtë kohë ta kufizojnë me një afat minimal dhe me një afat maksimal, le ta bëjnë.

Xhemal Qefalia – Zonja kryetare, nuk doja t'ju ndërprisja se ishit shumë e qartë, por duhet pasur parasysh diçka nga Ministria e Drejtësisë, pasi ka përvoja të tilla ndërkombëtare dhe unë nuk jam dakord me atë që thotë zëvendësministria, sepse janë penalizuar shtete pikërisht nga sanksione të tilla, që po përdoren si në rastin konkret. Ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm me respektimin e lirive dhe të të drejtave të njeriut dhe s' duhet të mendojmë se duke marrë këtë masë, zgjidhim çdo lloj problemi. Kjo ishte arsyeja që ndërhyra.

Ermonela Felaj – Faleminderit, koleg!

Me të drejtë të takonte të ishe relator i këtij projektligji për shkak të përvojës tënde. Jemi të sigurt që kjo do të na ndihmonte.

Janë disa çështje që i ka marrë në evidencë GJEDNJ-ja dhe na kërkohet që të kujdesemi që të drejtat të kufizohen në mënyrë proporcionale me qëllimin dhe nevojën që kemi.

Vazhdojmë me pikën tjetër, ku kemi vetëm një ndërhyrje. Ju keni thënë se kërkesa ankimore depozitohet në gjykatën e rrethit gjyqësor, që është kompetente për gjykimin e çështjes sipas parashikimit të nenit 470 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata procedon sipas mënyrës së parashikuar në nenin 471 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes nuk e pezullon vendimin e ministrit të Drejtësisë. Pak a shumë, ky është edhe formulimi që ka bërë edhe EURALIUS-i. A i qëndroni këtij formulimi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë, i cili ka vendosur zgjatjen e regjimit të posaçëm, i dënuari, i paraburgosuri ose mbrojtësi i tij, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë brenda 20 ditëve, nga momenti i njoftimit të vendimit. Duhet të korrigjojmë termat, sepse në Kodin e

Procedurës Penale nuk thuhet “kërkesë”, por thuhet “ankim”, kjo gjykohet nga gjykata kompetente, sipas nenit përkatës.

Kalojmë në pikën 8 të nenit 13/1, që ka të bëjë me rastin kur kërkesa kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë pranohet nga gjykata. Fjala “kërkesë”, të zëvendësohet me fjalën “ankim” në çdo rast.

“Në qoftë se ankimi kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë pranohet nga ana e gjykatës, ministri i Drejtësisë, në rast se do të urdhërojë një vendim të ri, duhet të mbajë parasysh përcaktimet e bëra në vendimin e gjykatës, duke shtuar elemente të reja që nuk janë vlerësuar ose nuk njiheshin më parë nga ministri. Edhe ndaj këtij vendim i ri mund të ushtrohet ankim sipas përcaktimit në pikën 6 të këtij neni.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ti nuk i shton vendimit të gjykatës, por gjykata duke parë situatën të thotë nëse do ta mbash në regjimin e posaçëm me 1-2-3 masa nga 10.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ministrja do të zbatojë 3 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk shton ministrja mbi vendimin e gjykatës. Është e kundërta, Xhemal. Ministri do të zbatojë vendimin e gjykatës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elemente të reja, ose që nuk janë vlerësuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë i kuptoj si elemente të reja, që i shton vetë gjykata, që nuk i ka vlerësuar më parë ministri.

Xhemal Qefalia – Po të ishte kështu, vihej pikë te përcaktimet e bëra nga vendimi i gjykatës dhe këtu ka elemente të reja, të vjetra dhe çdolloj vendimi që ka dhënë gjykata.

Ndërkohë, ti vë një presje këtu dhe shkruan: “... duke shtuar elemente të reja, ose që nuk janë vlerësuar ose nuk njiheshin më parë nga ministri.” Kjo është nonsens dhe mendoj se cenon të liritë dhe të drejtat e njeriut

Ermonela Felaj – Pyetja është: ministri merr vendim ta zgjasë edhe një vit regjimin e posaçëm. I dënuari dhe i paraburgosuri ankohen në gjykatë. Gjukata vendos të pranojë ankimin e tyre. Çfarë ndodh në këtë rast, a merr vendim përsëri ministri? Teorikisht nuk mund

të marrë. Në këto kushte, ai duhet të zbatojë vendimin e gjykatës, i cili ose e rrëzon vendimin e ministrit ose e konfirmon atë.

Julian Hodaj – Ideja e normës është se kjo bëhet duke pasur parasysh përcaktimin e gjykatës, që do të thotë se për ato elemente, të cilat gjykata i ka vlerësuar dhe është shprehur, ministrit nuk i lejohet më të ketë një mendim të kundërt, por ministri në çdo rast mund të marrë në konsideratë lëshimin e një urdhri të ri për regjimin e posaçëm. Kjo do të thotë se ministri në çdo rast mund të marrë në konsideratë elemente të reja që kanë lindur si të tilla ose elemente që nuk janë vlerësuar ose nuk njiheshin më parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është urdhër i ri për regjimin e posaçëm, nuk është i vjetri, as shtim apo pakësim i urdhrit të vjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përsëri mund të ankohet, se kemi të bëjmë me elemente të reja.

Xhemal Qefalia – Më falni!

Zoti zëvendësministër, ju nuk jeni marrë drejtpërdrejt me hartimin e këtij drafti, sepse këtë draft e ka sjellë Ministria e Drejtësisë dhe nuk është kështu. Po që se do të vazhdojë kështu: vendim, përsëritje, vendim, përsëritje, vendim, nuk mbaron asnjëherë.

Ermonela Felaj – Vendosja e fjalisë në fund: “Edhe ndaj këtij urdhri të ri mund të ushtrohet ankim në gjykatë sipas përcaktimit në pikën 6 të këtij neni”, do të na ndihmonte që në çdo rast t’i jepnim të drejtë të dënuarit, të paraburgosurit ose mbrojtësit të tij.

Urdhëroni, zonja Vodo!

Teuta Vodo – Shumë shkurt, shprehja “vetëm nëse ka elemente të reja” është shkruar shumë qartë.

Ermonela Felaj – Është e qartë, por këto elemente të reja ose nuk janë ditur për arsye objektive, ose kanë lindur mbasi është dhënë vendimi i gjykatës, por në përsëri duhet t’ua njohim të drejtën e ankimit. Edhe kur ti e vendos në regjim të posaçëm, ai ka të drejtë të ankohet. Kështu, mendoj të shtojmë një fjali dhe besoj se e sistemojmë këtë moment.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, në fund vendimin e merr gjykata.

A jemi dakord me këtë riformulim të kësaj pjese? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Atëherë, nëse kolegët janë të qartë me diskutimin që bëmë deri tani, a mund të kalojmë në votimin në tërësi të draftit apo ndonjë koleg ka diçka për të shtuar?

Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar””.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji.

Faleminderit!

Të gjitha mendimet e shprehura në komision do të referohen në raportin për Komisionin e Ligjeve.

Falënderoj të dy zëvendësministrat për angazhimin e tyre!

Kolegë, ju kërkoj vetëm një minutë!

MBYLLET MBLEDHJA